

PROCESVERBAL

I

MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË GJYKATËS SË LARTË

Tiranë, më 02.04.2026

Me datë 02.04.2026, me kërkesën dhe nën drejtimin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, u zhvillua mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë.

Mbledhja e Këshillit të Gjykatës së Lartë, e cila i ishte njoftuar 3 ditë para anëtarëve të Këshillit së bashku me materialet përkatëse, kishte në rend dite çështjet si vijon:

- Intervista me kandidatët e kualifikuar për 1 (një) vend vakant – “*sekretare gjyqësore*”, Sektori i regjistrimit të çështjeve gjyqësore”, në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor, kategoria IV-I dhe 1 (një) vend vakant – “*sekretare gjyqësore*”, Sektori i sekretarisë gjyqësore, kategoria IV-I, në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor,
- Të ndryshme.

Këshilli i Gjykatës përbëhej nga anëtarët si vijon:

1. Sokol SADUSHI - Kryetar i Gjykatës së Lartë
1. Ilir PANDA - Anëtar Gjykatës së Lartë
2. Kelment GRECA - Përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor

Të pranishëm në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës ishin edhe:

- 1) A. V. - Drejtore e Kabinetit të Kryetarit;
- 2) M. K. - Këshilltar në kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
- 3) A. K. - Kancelare e Gjykatës së Lartë
- 4) J. T. - Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë
- 5) V. XH. - Specialiste IT në Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit dhe Sigurisë.
- 6) I. Q. - Sekretare gjyqësore

Në fjalën hyrëse, Kryetari i Gjykatës së Lartë, z. Sokol Sadushi, pasi konstatoi prezencën e dy anëtarëve të tjerë të Këshillit, deklaroi të hapur mbledhjen e Këshillit, me rendin përkatës të ditës, i cili u miratua, dhe vijoi me çështjen e parë të rendit të ditës, që lidhej me intervistën dhe vlerësimin e kandidatëve për plotësimin e pozicioneve vakante të shpallura në Gjykatën e Lartë në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor, dhe konkretisht për pozicionin – një “*sekretare gjyqësore*” dhe një “*sekretare e regjistrimit të çështjeve*”.

Lidhur me çështjen e parë, që kishte të bënte me intervistimin e kandidatëve të kualifikuar në fazën finale të konkurimit për vendet vakante “*sekretare gjyqësore*” dhe “*sekretare e regjistrimit të çështjeve*”, anëtarët e Këshillit vijuan me intervistën e kandidatëve të kualifikuar për këto pozicione vakante.

Në përfundim të procesit të intervistimit të kandidatëve, Këshilli i Gjykatës së Lartë përzgjodhi në pozicionin “*sekretare gjyqësore*” zj. O. O dhe në pozicionin “*sekretare e regjistrimit të çështjeve*” zj. S.L., në Drejtorinë e Administrimit Gjyqësor.